



**KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE**  
**KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE**

**RISHPALLJE APLIKIMI PËR EKSPERTË KONTABËL TË LICENSUAR (AUDITUES LIGJOR) PËR AUDITIMIN E PARTIVE POLITIKE PËR VITIN KALENDARIK 2020.**

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes këtij njoftimi, bën thirrje publike për shfaqje interesi për të qenë ekspert kontabël të licensuar (auditues ligjor) për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik 2020.

Ekspertët kontabël të licensuar (audituesit ligjor), përveç kushteve të përgjithshme të ushtrimit të profesionit të përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duhet të plotësojnë njëkohësisht edhe kriteret e mëposhtme:

- a. Të ushtrojnë profesionin e ekspertit kontabël të licensuar (audituesit ligjor) për jo më pak se 5 (pesë) vitet e fundit;
- b. Të mos kenë masë disiplinore në fuqi;
- c. Të mos jetë anëtar i ndonjë partie politike në 5 (pesë) vitet e fundit;
- d. Të mos ketë qenë kandidat i mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit në dy zgjedhjet e fundit;
- e. Prindërit, bashkëshorti/ja, bashkëjetuesi/ja dhe fëmijët madhorë të mos jenë anëtarë i partisë politike objekt i auditimit.

Aplikantët duhet të dorëzojnë brenda datës 29.06.2021 në mënyrë elektronike në email-in [Enxhi.Podgorica@kqz.gov.al](mailto:Enxhi.Podgorica@kqz.gov.al) ose fizikisht pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dokumentat si më poshtë vijon:

- a) Kopje të noterizuar të licencës të ekspertit kontabël të licensuar (auditues ligjor), lëshuar nga IEKA, e vlefshme për vitin kalendarik respektiv;
- b) Vërtetim nga IEKA që vërteton se eksperti kontabël i licensuar (audituesi ligjor) ka jo më pak se 5 (pesë) vite eksperiencë dhe se nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- c) Fotokopje të dokumentit të identifikimit;
- d) Deklaratë vetjake se nuk është në kushtet e parashikuara në shkronjat “c”, dhe “d”, të sipërcituar, sipas formatit të miratuar në shtojcën 1 bashkëlidhur udhëzimit nr. 14 datë 09.06.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”;

- e) Raport mjeko-ligjor.
- f) Vërtetim të gjendjes gjyqësore.

Pas përfundimit të periudhës së aplikimit, Komisioni i Posaçëm i ngritur me urdhër të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve realizon, brenda 5 (pesë) ditëve, verifikimin e plotësisht të kritereve formale të sipërcituara. Brenda 5 (pesë) ditëve nga miratimi i listës paraprake, Komisioni i Posaçëm kryen procedurën e intervistimit me kandidatët e kualifikuar me qëllim vlerësimin e aftësive komunikuese e qasjes sociale të tyre dhe brenda 3 (tre) ditëve hidhet shorti për caktimin e ekspertëve kontabël të licensuar (audituesve ligjor).

## **FORMULAR VETËDEKLARIMI**

Deklaruesi

Unë i/e nënshkruari/a \_\_\_\_\_, në cilësinë e ekspertit/es kontabël të licensuar (audituesit ligjor) me dokument identifikimi nr \_\_\_\_\_, deklaroj se nuk jam në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon udhëzimi nr. \_\_, datë \_\_.\_\_.2021, i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, “Për caktimin e kriterëve, procedurat për përzgjedhjen dhe emërimin e ekspertëve kontabël të licensuar dhe kushtet kontraktuale për auditimin e fondeve të përfituara dhe të shpenzuara nga partitë politike gjatë vitit kalendarik dhe subjektet zgjedhore dhe kandidatët e tyre në fushatën zgjedhore”, pasi nuk kam qenë për 5 (pesë) vitet e fundit anëtar i ndonjë partie politike, si dhe për 2 (dy) vitet e fundit nuk kam qenë kandidat i mbështetur nga ndonjë parti politike, koalicion apo kandidat i propozuar nga zgjedhësit.

Kjo deklaratë është hartuar më të dhënat në ditën e deklaramit.

**Kujdes! Deklaruesi mban përgjegjësi personale për deklaram të rremë.**

Data e dorëzimit të deklaratës \_\_.\_\_.\_\_

**Deklaruesi**

(Emër, Mbiemër, Firmë)

